



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.7

25 janar

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i GJK nr.2, datë 12.1.2007	Me objekt deklarin e mbarimit të mandatit të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese, zonjës Vjollca Meçaj.....	99
Vendim i GJK nr.3, datë 12.1.2007	Me objekt deklarin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, zotit Kristofor Peçi.....	99
Vendim i GJK nr.4, datë 12.1.2007	Me objekt deklarin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, zotit Alfred Karamuço.....	100
Udhëzim i KQZ nr.1, datë 16.1.2007	Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr.11, datë 5.12.2006 të KQZ-së “Për organizimin dhe funksionimin e komisionit të qendrës së votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”	101
Udhëzim i KQZ nr.2, datë 18.1.2007	Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr.13, datë 19.12.2006 “Për caktimin dhe përgatitjen e vendit të numërimit të votave, dhe mënyrën e ngritjes së grupeve të numërimit”	102
Udhëzim i KQZ nr.4, datë 20.1.2007	Për miratimin e rregullave për ngritjen e grupeve të njoftimit dhe evidentimit (GNE) dhe procedurën e evidentimit të shtetasve shqiptarë që kanë emigruar jashtë vendit, të cilët janë në listën e zgjedhësve.....	103

VENDIM
Nr.2, datë 12.1.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i	Gjykatës Kushtetuese		
Alfred Karamuço	Anëtar i	“	“	
Fehmi Abdiu	Anëtar i	“	“	
Kristofor Peçi	Anëtar i	“	“	
Kujtim Puto	Anëtar i	“	“	
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“	
Petrit Plloçi	Anëtar i	“	“	
Sokol Sadushi	Anëtar i	“	“	

me sekretare Brunilda Bara, në datën 12.1.2007, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese.

OBJEKTI: Deklarimi i mbarimit të mandatit të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese, zonjës Vjollca Meçaj.

BAZA LIGJORE: Neni 127/2 i Kushtetutës, si dhe neni 9/2 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi shqyrtoi kërkesën,

VËREN:

Me dekretin nr.4353, datë 21.10.2004 të Presidentit të Republikës, zonja Vjollca Meçaj është emëruar gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese për pjesën e mbetur të mandatit të gjyqtarit Zija Vuci.

Rezulton se gjyqtari Zija Vuci, i emëruar për një periudhë 12-vjeçare, betimin para Presidentit të Republikës e ka bërë në datën 24.12.1994. Për rrjedhojë, data 24.12.2006 konsiderohet si datë e mbarimit të mandatit të gjyqtares Vjollca Meçaj.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 127/2 të Kushtetutës, si dhe nenit 9/2 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Të deklarojë mbarimin e mandatit të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese, zonjës Vjollca Meçaj, në datën 24.12.2006.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

VENDIM
Nr.3, datë 12.1.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i	Gjykatës Kushtetuese		
Alfred Karamuço	Anëtar i	“	“	
Fehmi Abdiu	Anëtar i	“	“	
Kujtim Puto	Anëtar i	“	“	
Vjollca Meçaj	Anëtare e	“	“	
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“	
Petrit Plloçi	Anëtar i	“	“	
Sokol Sadushi	Anëtar i	“	“	

me sekretare Brunilda Bara, në datën 12.1.2007, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të

hapura kërkesën e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese.

OBJEKTI: Deklarimi i mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, zotit Kristofor Peçi.

BAZA LIGJORE: Neni 127/2 i Kushtetutës, si dhe neni 9/2 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi shqyrtoi kërkesën,

VËREN:

Me vendimin nr.303, datë 20.3.1997 të Kuvendit të Shqipërisë, zoti Kristofor Peçi është zgjedhur gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese për pjesën e mbetur të mandatit të gjyqtarit Metush Saraçi.

Rezulton se gjyqtari Metush Saraçi, i zgjedhur për një periudhë 12-vjeçare, betimin para Presidentit të Republikës e ka bërë në datën 24.12.1994. Për rrjedhojë, data 24.12.2006 konsiderohet si datë e mbarimit të mandatit të gjyqtarit Kristofor Peçi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 127/2 të Kushtetutës, si dhe nenit 9/2 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Të deklarojë mbarimin e mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, zotit Kristofor Peçi, në datën 24.12.2006.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

VENDIM

Nr.4, datë 12.1.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i	Gjykatës Kushtetuese		
Fehmi Abdiu	Anëtar i	“	“	
Kristofor Peçi	Anëtar i	“	“	
Kujtim Puto	Anëtar i	“	“	
Vjollca Meçaj	Anëtare e	“	“	
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“	
Petrit Ploçi	Anëtar i	“	“	
Sokol Sadushi	Anëtar i	“	“	

me sekretare Brunilda Bara, në datën 12.1.2007, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese.

OBJEKTI: Deklarimi i mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, zotit Alfred Karamuço.

BAZA LIGJORE: Neni 127/2 i Kushtetutës, si dhe neni 9/2 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi shqyrtoi kërkesën,

VËREN:

Me dekretin nr.981, datë 9.12.1994 të Presidentit të Republikës, zoti Alfred Karamuço është emëruar gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese për një periudhë 12-vjeçare.

Rezultoni se betimin para Presidentit të Republikës e ka bërë në datën 24.12.1994. Për rrjedhojë, data 24.12.2006 konsiderohet si datë e mbarimit të mandatit të gjyqtarit Alfred Karamuço.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 127/2 të Kushtetutës, si dhe nenit 9/2 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Të deklarojë mbarimin e mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, zotit Alfred Karamuço, në datën 24.12.2006.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

UDHËZIM

Nr.1, datë 16.1.2007

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË UDHËZIMIN NR.11, DATË 5.12.2006 TË KQZ-SË “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE”

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 29 pika 1, nenit 31 pika 1 germa “b”, nenit 45 e vijues të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZON:

Neni 1

1. Pika 1 e nenit 3 ndryshon si më poshtë:

Anëtarët e KQV-së, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, emërohen nga KZQV-ja, me propozime nga partitë politike, si më poshtë:

- Një anëtar i propozuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë;
- Dy anëtarë të propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë;
- Një anëtar i propozuar nga Partia Republikane Shqiptare;
- Një anëtar i propozuar nga Partia Demokrate e Re;
- Një anëtar i propozuar nga Partia Agrare Ambientaliste;
- Një anëtar i propozuar nga Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut;
- Një anëtar i propozuar nga Partia Socialdemokrate e Shqipërisë;
- Një anëtar i propozuar nga Partia Lëvizja Socialiste për Integrim;
- Një anëtar i propozuar nga Partia Demokristiane;
- Një anëtar i propozuar nga Partia Demokracia Sociale;
- Një anëtar i propozuar nga Partia Aleanca Demokratike;
- Anëtari i trembëdhjetë propozohet në gjysmën e KQV-ve nga Partia Demokratike e Shqipërisë, ndërsa në gjysmën tjetër nga Partia Socialiste e Shqipërisë, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 5 të këtij udhëzimi.

2. Pika 3 e nenit 3 ndryshon si më poshtë:

a) Në komisionet e qendrave të votimit, në të cilat anëtari i trembëdhjetë i përket Partisë Demokratike, KZQV-ja emëron kryetarin e KQV-së sipas propozimit të paraqitur nga kjo parti. Në këto komisione, KZQV-ja emëron zëvendëskryetarin njërin nga anëtarët e propozuar nga Partia Socialiste sipas propozimit të paraqitur nga kjo parti.

b) Në komisionet e qendrave të votimit në të cilat anëtari i trembëdhjetë i përket Partisë Socialiste, KZQV-ja emëron kryetarin e KQV-së sipas propozimit të paraqitur nga kjo parti. Në këto komisione, KZQV-ja emëron zëvendëskryetarin anëtarin e propozuar nga Partia Demokratike.

Neni 2

Në nenin 5, fjala “shtatë” bëhet “trembëdhjetë”.

Neni 3

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

UDHËZIM
Nr.2, datë 18.1.2007

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR.13, DATË 19.12.2006 “PËR
CAKTIMIN DHE PËRGATITJEN E VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE, DHE MËNYRËN E
NGRITJES SË GRUPEVE TË NUMËRIMIT”**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 29 pika 1, nenit 95, nenit 95/1, nenit 95/2, nenit 109/3, nenit 109/4, nenit 109/5 dhe nenit 109/6 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZON:

Neni 1

Neni 6 pika 4, germat “a” dhe “b”, ndryshojnë si më poshtë:

- a) Tavolina pune dhe 14 karrige për KZQV-në;
- b) Treshe tavolinash (vendosen në formë T-je sipas shpjegimit në skemën orientuese) me nga 14 karrige për çdo grup të numërimit të votave.

Neni 2

1. Në nenin 7 pika 6, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

I.

- A) Në bashkitë, të cilat kanë nga 2 deri 8 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e një grupi numërimi;
- B) Në bashkitë, të cilat kanë nga 9 deri në 14 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e dy grupeve të numërimit;
- C) Në bashkitë, të cilat kanë nga 15 deri në 19 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e tri grupeve të numërimit;
- D) Në bashkitë, të cilat kanë nga 20 deri në 29 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e katër grupeve të numërimit;
- E) Në bashkitë, të cilat kanë nga 30 deri në 45 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e pesë grupeve të numërimit;
- F) Në bashkitë, të cilat kanë nga 46 deri në 70 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e tetë grupeve të numërimit;
- G) Në bashkitë, të cilat kanë nga 71 deri në 100 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e dhjetë grupeve të numërimit;
- H) Në njësitë bashkiake të Tiranës, KZQV-ja cakton ngritjen e dhjetë grupeve të numërimit;
- I) Në bashkinë Durrës, KZQV-ja cakton ngritjen e dymbëdhjetë grupeve të numërimit.

II.

- A) Në komunat, të cilat kanë 2 deri 9 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e një grupi numërimi;
- B) Në komunat, të cilat kanë 10 deri 15 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e dy grupeve të numërimit;
- C) Në komunat, të cilat kanë 16 deri 19 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e tri grupeve të numërimit;
- D) Në komunat, të cilat kanë 20 deri 30 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e katër grupeve të numërimit.

2. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

Çdo grup numërimi përbëhet nga 13 anëtarë dhe sekretari.

3. Shtohet pika 8, si më poshtë:

Në të gjitha rastet, KZQV-ja duhet të ketë parasysh se një grup numërimi numëron jo më pak se 5 qendra votimi dhe jo më shumë 15 qendra votimi.

Neni 3

1. Pika 1 e nenit 8 ndryshohet si më poshtë:

Dhjetë ditë përpara ditës së zgjedhjeve, KZQV-ja njofton subjektet zgjedhore përkatëse të paraqesin propozimet për anëtarë të GNV-ve. KZQV-ja merr vendim për caktimin e grupeve të numërimit dy ditë para datës së zgjedhjeve.

2. Në pikën 3 të nenit 8 shtohet ky paragraf:

Në rastin kur zëvendëskryetari i KZQV-së është propozuar nga Partia Socialiste, ajo ka të drejtë të paraqesë propozime për tre anëtarë të grupit të parë të numërimit, njëri prej të cilëve caktohet nga KZQV-ja, kryetar i këtij grupi numërimi.

3. Në pikën 4 të nenit 8 shtohet ky paragraf:

Në rastin kur kryetari i KZQV-së është propozuar nga Partia Socialiste, ajo ka të drejtë të paraqesë propozime për tre anëtarë të grupit të dytë të numërimit, njëri prej të cilëve caktohet nga KZQV-ja, kryetar i këtij grupi numërimi.

Neni 4

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

UDHËZIM

Nr.4, datë 20.1.2007

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR NGRITJEN E GRUPEVE TË NJOFTIMIT DHE EVIDENTIMIT (GNE) DHE PROCEDURËN E EVIDENTIMIT TË SHTETASVE SHQIPTARË QË KANË EMIGRUAR JASHTË VENDIT, TË CILËT JANË NË LISTËN E ZGJEDHËSVE

Në mbështetje të nenit 29 pika 1 dhe nenit 181/2 pika 11 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

UDHËZON:

Neni 1

Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë rregullat për ngritjen e grupeve të përbashkëta të njoftimit dhe evidentimit (GNE), si dhe procedurën e evidentimit të shtetasve shqiptarë që kanë emigruar jashtë vendit, të cilët janë në listën e zgjedhësve.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllimet e këtij udhëzimi:

1. “Të emigruar” konsiderohen shtetasit shqiptarë që janë larguar nga Republika e Shqipërisë dhe banojnë përkohësisht në vende të tjera.

2. “Familjar i afërt” konsiderohen prindërit, bashkëshortët, vëllezërit dhe motrat, si dhe fëmijët madhorë bashkëjetues me zgjedhësin e emigruar.

Neni 3

Grupet e njoftimit dhe evidentimit

1. Evidentimi i shtetasve shqiptarë që kanë emigruar jashtë vendit bëhet nga grupet e njoftimit dhe evidentimit të përbërë nga dy anëtarë.

2. Anëtarët e grupeve të njoftimit dhe evidentimit emërohen nga KZQV-ja si më poshtë:

a) Një anëtar i grupit të evidentimit propozohet nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore dhe është personi i cili bën njoftimin sipas nenit 56 të Kodit Zgjedhor;

b) Një anëtar propozohet nga partia më e madhe e spektrit të kundërt politik me kryetarin e njësisë së qeverisjes vendore;

c) Anëtarët e GNE-ve, si rregull, duhet të plotësojnë kriteret e anëtarit të KQV-së.

3. Çdo KZQV merr vendim për ngritjen e grupeve të njoftimit dhe evidentimit (GNE) për çdo qendër

votimi brenda datës 21 janar 2007.

Neni 4

Procedura e evidentimit nga GNE-të

1. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, nëpërmjet zyrave të gjendjes civile, përgatit për çdo qendër votimi një dosje, e cila përmban:

- a) listën paraprake të zgjedhësve;
- b) njoftimin e zgjedhësve;
- c) deklaratat tip për evidentimin e të emigruarve, sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. GNE-të pajisen nga zyrat e gjendjes civile me dosjen, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni.

3. Pas procedurës së njoftimit, GNE pyet familjarët e afërt nëse një ose disa nga personat e familjes kanë emigruar.

4. Kur nuk është e mundur marrja e informacionit sipas pikës 3 të këtij neni, për shkak se asnjë nga anëtarët e familjes nuk ndodhet në shtëpi, GNE njofton menjëherë KZQV-në, e cila mban shënim orën dhe datën. GNE rikthehet brenda së njëjtës date për të kontaktuar me zgjedhësit të cilët nuk u gjenden në banesë. Nëse edhe në këtë rivefikim kontaktimi nuk është i mundur, GNE kontakton me fqinjët dhe pasi sigurohet për identitetin e tyre, kërkon informacion në lidhje me zgjedhësin që nuk gjendet në banesë, nga të paktën dy prej fqinjëve që i përkasin familjeve të ndryshme.

5. Në rastet kur të paktën një prej personave të përmendur në pikën 3 të këtij neni, deklaron se zgjedhësi/zgjedhësit kanë emigruar jashtë vendit, GNE plotëson deklaratën model 01 GNE për evidentimin e të emigruarve, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Në rastet kur personat e përmendur në pikën 4 të këtij neni, deklarojnë se zgjedhësi/zgjedhësit kanë emigruar jashtë vendit, GNE plotëson deklaratën model 02 GNE për evidentimin e të emigruarve, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Një kopje e deklaratës i lihet deklaruesit/deklaruesve.

6. Deklarata është e vlefshme vetëm në rastin kur nënshkruhet nga familjarët e afërt bashkëjetues me të emigruarin sipas përcaktimit të pikës 3, ose fqinjët e të emigruarit sipas përcaktimit të pikës 4 të këtij neni, si dhe dy anëtarët e GNE-së.

7. Kur njëri nga dy anëtarët e GNE-së nuk nënshkruan deklaratën e evidentimit të personit të emigruar, atëherë çështja i kalon për shqyrtim KZQV-së. Kjo e fundit shënon shkakun e kundërshtimit në librin e protokollit të mbledhjeve dhe bën vetë verifikimin brenda ditës. Pas verifikimit, KZQV-ja merr vendim. Ky vendim është i detyrueshëm për zbatim nga GNE.

8. Organet kompetente shtetërore kanë detyrimin t'i kthejnë përgjigje KZQV-së brenda 24 orëve në lidhje me kërkesat e saj në zbatim të këtij udhëzimi.

9. Pas marrjes së deklaratës, GNE shënon, përkrah emrit të zgjedhësit në listën paraprake të zgjedhësve, shkronjën "E".

Neni 5

Dokumentimi i deklaramit

Deklarimi pasqyrohet me shkrim në deklaratën tip, e cila përmban elementet e mëposhtme:

1. emrin, atësinë, mbiemrin dhe datëlindjen e deklaruesit;
2. llojin dhe numrin e dokumentit të identifikimit;
3. lidhjen e tij me personin e evidentuar si emigrant;
4. emrin, atësinë, mbiemrin, numrin rendor në listën e zgjedhësve të personit të evidentuar si i emigruar;
5. të dhëna të tjera në lidhje me vitin e emigrimit dhe shtetin në të cilin jeton personi i evidentuar si i emigruar;
6. datën dhe orën e deklaramit;
7. nënshkrimet e deklaruesit/deklaruesve dhe të anëtarëve të GNE-së.

Neni 6

Raportimi në zyrën e gjendjes civile

Grupet e njoftimit dhe evidentimit dorëzojnë deri në orën 10 të ditës pasardhëse deklaratat e

plotësuar, si dhe një fotokopje të nënshkruar të listës paraprake të zgjedhësve me shënimet përkatëse. Dorëzimi bëhet me procesverbal, ku shënohet numri i deklaratave, numri i shtetasve të evidentuar si të emigruar dhe numrat e tyre rendorë në listën e zgjedhësve. Procesverbali hartohet në tri kopje, një për zyrën e gjendjes civile dhe një për secilin anëtar të GNE-së.

Neni 7

Veprimtaria e zyrave të gjendjes civile

Zyra e gjendjes civile, mbi bazën e deklaratave të marra, bën shënimin në krah të emrit të zgjedhësit të evidentuar si i emigruar, në listën e zgjedhësve, jo më vonë se 24 orë nga marrja e deklaratave. Zyra e gjendjes civile dërgon informacion periodik në KZQV-të përkatëse. Për çdo zyrë të gjendjes civile, caktohet një monitorues nga partia më e madhe e spektrit të kundërt politik me kryetarin e njësisë së qeverisjes vendore.

Neni 8

Afati i përfundimit të punës

Procesi i njoftimit dhe evidentimit duhet të përfundojë jo më vonë se data 6 shkurt 2007. Në çdo rast, shpallja e listës përfundimtare të zgjedhësve nuk pengohet nga ecuria e këtij procesi.

Neni 9

Administrimi i deklaratave të evidentimit

1. Zyra e gjendjes civile ruan dhe administron deklaratat për evidentimin e shtetasve të emigruar.
2. Zyra e gjendjes civile dërgon një kopje të vulosur për secilën deklaratë në KZQV. Kopjet e deklaratave sipas kësaj pike shoqërohen me një procesverbal evidence.

Neni 10

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpërblen për punën e kryer anëtarët e grupeve të njoftimit dhe evidentimit dhe monitoruesit.

Neni 11

Anëtarët e GNE-së, për evidentime të pasakta të kryera me faj në kundërshtim me dispozitat e këtij udhëzimi, mbajnë përgjegjësi administrative sipas nenit 178 pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Neni 12

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
 Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË	
2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR	
3. REGJISTRAT E NOTERISË	
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:	
1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

Botime të reja

1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5 PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
7 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
8 PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
9 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE.....	500

Hyri në shtyp më 23.1.2007
 Doli nga shtypi më 25.1.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Grafon”
 Tiranë, 2007

Çmimi 12 lekë